



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 24 Prot.
2024

Tiranë, më 08 . 01 .

V E N D I M

Nr. 1, Datë 08 . 01 . 2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 261 Regj., datë 30.11.2023, paraqitur nga E. S, kundër Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Berat, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “gjinisë”, “identitetit gjinor¹” dhe “çdo shkak tjetër²”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, E. S, në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit shprehet si më poshtë vijon:
“Jam punonjëse pranë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Berat. Pas konkurimit kam fituar të drejtën e punësimit në këtë institucion dhe pasi përfundova kursin e shkurtër disa javor në IEVP Fier, kam filluar të punoj pranë IEVP Berat.

Në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore, jam caktuar që të punoj si roje me armë zjarri në kullën e vrojtimit në regjimin e jashtëm, edhe pse nuk kisha asnjë ditë pune në këtë institucion, detyrë të cilën vazhdoj ta kryej edhe sot.

¹ Kërkuar sqarime ankueses nga inspektori nëpërmjet e-maileve datë 14.12.2023, 20.12.2023 dhe 21.12.2023. Ankuesja nuk i është përgjigjur e-mailit.

² Subjekti ankues ka shpjeguar se në këtë shkak ka klasifikuar ankesën e paraqitur prej saj pranë Drejtorisë së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve (DSHKB).

³ Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

Pas fillimit të punës, pas afro 10 ditësh, jam përballur me ngacmime seksuale nga punonjësi të këtij institucioni. Duke qenë se këto veprime nuk pajtoheshin me moralin tim personal e familjar, në datën 28.08.2023, kam paraqitur kallëzim në Drejtorinë e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve (DSHKB), duke kallëzuar punonjësin e policisë A. H, punonjës i I EVP Berat. Në kallëzimin tim jam ankuar se ky shtetas prej disa ditësh më përndjek dhe më shqetëson nëpërmjet telefonit. Gjithashtu kam kallëzuar se ky shtetas nëpërmjet telefonit më ka ngacmuar seksualisht dhe se më ka premtuar se do të më marrë në regjimin e brendshëm. Në kallëzimin tim kam insistuar se është konsumuar vepra penale e “Përndjekjes” dhe ajo e “Ngacmimit seksual”.

Pasi SHKB nisi të kryejë verifikimet përkatëse, nga ana e drejtuesve të I EVP Berat kanë nisur menjëherë “hakmarrjet” ndaj kallëzimit tim.

Kështu, ndonëse kam paraqitur raport shëndetësor për një ndërhyrje kirurgjikale që kam kryer, dhe kam kërkuar që të mos qëndroj në kushtet e motit të ftohtë në regjimin e jashtëm, si shenjë hakmarrjeje ndaj veprimeve të mija kallëzuese dhe ankuese, drejtuesit të I EVP Berat, kanë refuzuar të gjitha kërkesat e mija.

Përveç refuzimit të kërkesave që kam bërë për arsye objektive, duke kërkuar të drejtat e mija, nga drejtuesit e I EVP Berat dhe strukturat e tjera në varësi, më është krijuar një atmosferë mbytëse dhe denigruese, e cila shfaqet në reagimin përbuzës ndaj çdo veprimi që unë kryej gjatë orarit të punës. Nuk kam dashur që situatën ta bëj publike në media, nuk dua të lëndoj asnjë familje, ndaj kam ndjekur dhe po ndjek rrugën ligjore, fillimisht duke paraqitur ankimin tim në DSHKB, dhe pasi pashë që nuk u mor asnjë masë, u detyrova t'i shkruaj institucioneve më të larta të shtetit.

Detyra që unë kam pranuar është vërtet e karakterit ushtarak dhe e kam pranuar dhe kërkuar me shumë dëshirë, por kjo nuk do të thotë që nën justifikimin e regjimit ushtarak të kryhen veprime të paligjshme kundra meje.

Diskriminimi ndaj meje duket përveç sa më sipër edhe në faktin që unë jam femër dhe më kanë vendosur në kullën e vrojtimit me armë zjarri, dhe kjo në kundërshtim me pozicionin tim të punës për të cilin kam konkuruar. Ndërkohë që, për detyrën dhe pozitën time gjinore dhe familjare, pranë I EVP Berat, persona me të njëjta kushte janë në regjimin e brendshëm.

Përveç kësaj, nuk aplikohet rotacioni në kryerjen e shërbimit në pozicionet e tjera, ku unë kam të drejtë që në këtë fazë të punësimit të vendosem në periudhën e parë 1-vjeçare.”

Ankuesja pretendon se lënia e saj në punë në regjimin e jashtëm të I EVP Berat dhe moskalimi në regjimin e brendshëm, ka ardhur si hakmarrje e I EVP-së, për shkak të ankimimit dhe kallëzimit që ajo ka bërë pranë SHKB-së, si dhe për shkak të gjinisë së saj.

Subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që në përfundim të shqyrtimit të ankesës së saj: “Të konstatojë diskriminimin nga ana e I EVP Berat, për shkak të ankimimit pranë SHKB-së, si dhe marrjen e masave për ndalimin e ngacmimeve seksuale nga punonjësi të këtij institucioni.”

Pas pranimit të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me dokumentacionin provues lidhur me shkaqet e pretenduara nga ana e subjektit ankues, si dhe lidhur me provueshmërinë e disa prej deklarimeve të bëra prej saj kundrejt IEVP Berat.

Për këtë arsye, me datë 14.12.2023, ankuesja është kontaktuar nga inspektorja e çështjes nëpërmjet telefonit dhe i është kërkuar të plotësojë informacionin e dokumentacionin e nevojshëm, kërkesa të cilat u përcollën edhe me e-mail.

Në vijim, po me datë 14.12.2023, nëpërmjet e-mailit është proceduar me kërkesat për plotësimin e dokumentacionit e informacionit të nevojshëm për vijimin e shqyrtimit të ankesës së saj.

Në mungesë të përgjigjes nga ana e ankueses brenda afateve kohore të caktuara, i janë dërguar sërish e-maile të tjera me datë 20.12.2023 dhe me datë 21.12.2023, duke i rikujtuar plotësimin e kërkesave të KMD-së⁴. Njëherësh subjekti ankues është telefonuar për disa ditë me radhë, por nuk i është përgjigjur më telefonatave të KMD-së.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare_ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

⁴ E-mailet e dërguara subjektit ankues janë depozituar në cilësi prove, në dosjen hetimore pranë KMD-së.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Në nenin 12, pika 1, shkronja c), të LMD, të ndryshuar, parashikohet se: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës. 2. Ndalohet çdo lloj shqetësimi, përfshirë edhe shqetësimin seksual, nga punëdhënësi përkundrejt një punëmarrësi ose një kërkuesi për punë ose midis punëmarrësve.*”

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Bazuar në deklaratimet e dokumentacionin e depozituar pranë KMD-së, rezulton se:

- Ankuesja është punësuar pranë IEVP Berat, pas një konkurimi për vendin e shpallur, sipas deklaratimit të saj. Komisioneri evidenton faktin se nuk është saktësuar nga ana e ankueses se për çfarë pozicioni ka konkuruar dhe për cilin pozicion pune të shpallur ka fituar. Nuk është depozituar asnjë akt emërimi apo kontratë individuale pune, ku të mund të pasqyrohej ky fakt.
- Është caktuar të punojë roje në kullën e vrojtimit në regjimin e jashtëm, pozicion për të cilin pretendon se nuk duhet të ishte caktuar ajo, si femër.
- Ankuesja pretendon se rreth 10 ditë pas fillimit të punës pranë IEVP Berat, ajo është ngacmuar seksualisht nga punonjësi i regjimit të brendshëm të burgut, A. H.
- Në datën 28.08.2023 ankuesja ka paraqitur kallëzim pranë Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve (SHKB), për përndjekje dhe shqetësim të natyrës seksuale nga ana e shtetasit A. H, punonjës i IEVP Berat.
- Mbi bazën e këtij kallëzimi, me datë 30.08.2023, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, është referuar materiali procedural me nr. 2217, i vitit 2023.
- Me datë 06.09.2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, ka disponuar me Vendim për mosfillimin e procedimit penal, lidhur me materialin procedural nr. 2217, të vitit 2023. Vendim kundër të cilit ankuesja ka ushtruar të drejtën e ankimimit pranë Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

- Në kronologji kohore, ankuesja pretendon se, në vijim të kallëzimit të kryer prej saj, ajo ka paraqitur raport mjekësor për të provuar gjendjen shëndetësore, pasi ishte operuar dhe në këto kushte nuk mund të qëndronte në mot të ftohtë në regjimin e jashtëm, por nuk është marrë në konsideratë nga ana e instancave të IEVP Berat, të cilët janë hakmarrë ndaj saj për shkak të kallëzimit të bërë pranë SHKB-së.

Lidhur me provueshmërinë e deklarimeve të ankueses, Komisioneri, në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar prej saj, që minimalisht të dëshmojë me prova shkresore apo të ndonjë forme tjetër të komunikimit zyrtar (e-maile, kërkesa) që ka njohur punëdhënësin me kërkesën e saj, fillimisht për gjendjen e saj shëndetësore, dhe mandej me faktin që për shkak të gjendjes shëndetësore dëshironte të kalonte në regjimin e brendshëm, me qëllim shmangien e qëndrimit në ambientin e jashtëm (regjimin e jashtëm të burgut).

Pavarësisht sa më sipër, subjekti ankues dëshmoi mungesë të theksuar bashkëpunimi, duke mos dërguar asnjë informacion për sa u kërkua nga Komisioneri.

Pas analizimit sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Sa i takon pretendimit të ankueses për diskriminim nga ana e IEVP Berat, për shkak se, pas kërkesave të saj për ta kaluar në regjimin e brendshëm, për arsye shëndetësore, nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim pozitiv për përmbushjen e saj, dhe se ajo ishte lënë të kryente shërbimin në regjimin e jashtëm në shenjë hakmarrjeje për kallëzimin e bërë prej saj pranë SHKB-së, dhe në faktin se është grua, Komisioneri vëren se, nuk rezulton i provuar në dokumentacion apo prova të tjera.

Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person posedon këto shkaqe, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara, por jo vetëm, duhet të parashtojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur.

Pala ankuese nuk parashtron e argumenton bindshëm me fakte e prova, mbi të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të personit përgjegjës që të jenë motivuar nga gjinia apo kallëzimi i saj në SHKB.

Ankuesja, nuk ka provuar se:

- Ka konkuruar dhe ka lidhur kontratën e punës për tu punësuar si roje në regjimin e brendshëm të IEVP-së.
- Ka paraqitur një kërkesë për kalimin e saj në regjimin e brendshëm;
- Ka paraqitur një dokument mjekësor apo shkresë tjetër për të vënë në dijeni punëdhënësin për gjendjen e saj shëndetësore;
- Ka paraqitur ndonjë shkresë, dokument apo provë tjetër që vërteton se IEVP Berat ka patur dijeni për kallëzimin e bërë prej saj në SHKB, kundrejt punonjësit A. H;

- Ka paraqitur ndonjë shkresë, dokument apo provë tjetër që vërteton se është ankuar pranë punëdhënësit për përndjekje apo shqetësim nga punonjësi A. H, apo të ketë kërkuar që IEVP Berat të ndër marrë masa për këtë problematikë.

Bazuar në përmbajtjen e Vendimit për mosfillimin e procedimit penal, datë 06.09.2023, të Prokurores D. P, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, në faqet 2-3 dhe 4, të tij, ndër të tjera, citohet se:

“Kallëzuesja ka deklaruar se nuk kishte njohur më parë asnjë punonjës në burgun e Beratit, përfshi edhe A. H, dhe shprehet se në lidhje me këtë ngjarje nuk kishte dijeni asnjë person apo institucion tjetër për ato çfarë i kishin ndodhur me punonjësin e policisë A. H, përveç SHKB-së.

.....Në analizë të rrethanave të shpjeguara më sipër, është e qartë se nuk jemi përpara veprës penale të “Përndjekjes”. Kallëzuesja në kallëzimin e saj ka shpjeguar se është njohur me shtetasin A. H, në IEVP Berat. Në ditët e para këto dy shtetas kanë komunikuar me njëri-tjetrin në lidhje me pozicionin e punës së kallëzueses. Në ditët në vijim, të dy shtetasit kanë pasur komunikime dhe biseda të vazhdueshme dhe janë takuar në Roskovec. Në kallëzim përveç faktit se kallëzuesja dhe i kallëzuarit kanë pasur komunikime dhe biseda të vazhdueshme, në asnjë rast kallëzuesja nuk shprehet se ajo kërcënohet ose ngacmohet nga shtetasi A. H me qëllim që t’i shkaktojë asaj një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi apo një personi, me të cilin ka lidhje shpirtërore, apo për ta detyruar të ndryshojë mënyrën e jetesës. Gjithashtu, edhe nga këqyrja e telefonit të kallëzueses, në asnjë rast nuk vërehen kërcënime apo ngacmime të tilla nga ana e shtetasit A. H. Për më tepër, ka komunikime nga ana e të dyja palëve dhe në asnjë rast kallëzuesja nuk ia shpreh personit tjetër se ndihet e kërcënuar apo e ngacmuar, por përkundrazi vazhdon bisedën normalisht dhe në disa raste është vetë ajo që provokon me anë të bisedave të ndryshme të kallëzuarin.”

Pra, bazuar në sa më sipër, nga këqyrja e përmbajtjes së këtij dokumenti, Komisioneri vëren se, IEVP Berat dhe asnjë person tjetër (sipas deklarimeve të vetë ankueses para SHKB-së) nuk ka patur dijeni për kallëzimin e saj. Pra, IEVP Berat nuk ka qenë në dijeni të këtij kallëzimi të ankueses.

Po ashtu, nisur nga fakti që Prokuroria ka disponuar me vendim mosfillimi procedimi penal lidhur me materialin procedural nr. 2217, të datës 30.08.2023, si dhe nga analizimi i përmbajtjes së këtij vendimi, rezulton se, IEVP Berat, nuk ishte në dijeni të këtij procedimi penal, e për pasojë as të kallëzimit të ankueses për ngacmim a shqetësim nga punonjësi A. H. Nuk është depozituar asnjë provë apo material tjetër provues që të dëshmojë se IEVP Berat ishte në dijeni të këtij kallëzimi.

Komisioneri vëren se, “viktimat” e diskriminimit e kanë detyrimin të paraqesin fakte dhe prova nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim apo mbi bazën e të cilave të bëjnë të besueshëm pohimin se është bërë diskriminim.

Pastaj, barra e provës i bartet të paditurit, i cili gjatë zhvillimit të procedurës hetimore duhet të dëshmojë se nuk ka pasur diskriminim, apo se ka pasur arsye ligjore për trajtim të pabarabartë.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme për plotësimin e ankesës, E. S ka shprehur mungesë të theksuar bashkëpunimi duke u mos iu përgjigjur asnjërit prej e-maileve apo telefonatave të inspektorit të çështjes. Kjo mungesë e theksuar e nivelit minimal të bashkëpunimit nga ana e ankueses me KMD-në, si organi që duhet të hetonte pretendimet e saj, në mungesë të provave e fakteve mbi të cilat supozohet se ka pasur diskriminim, pamundëson vijimin e procedurës për shqyrtimin e ankesës.

Vendimmarrja e Komisionerit duhet të jetë e arsyetuar dhe e argumentuar mbështetur në bazueshmërinë e provave e fakteve në gjykim. Kjo, pasi një moment kyç në gjykimin administrativ është edhe procesi i provueshmërisë mbi faktet objekt verifikimi, gjykimi, mbi të cilat bazohet një vendimmarrje e drejtë.

Faktet që janë objekt i të provuarit merren për bazë për efekt provueshmërie, vetëm kur ato janë paraqitur me saktësi dhe në formën e kërkuar nga ligji gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës. Për të formuar bindjen e tij, organi administrativ, në këtë rast Komisioneri, duhet të marrë parasysh si argumentet që flasin për ekzistencën e një fakti, ashtu dhe argumentet që flasin për mosegzistencën e tij.

Provat janë të dhëna që merren prej burimeve (subjektit ankues në këtë rast) dhe sipas rregullave të përcaktuara në ligj, të cilat vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet e palëve në proces (neni 11, i Kodit të Procedurës Civile).

Subjekti ankues i cili pretendon diskriminimin, ka detyrimin që të provojë me fakte, shpjegime e prova bindëse, nëpërmjet të cilave duhet të krijojë bindjen se mund të prezumohet diskriminimi.

Pala ankuese nuk parashtroi e depozitoi prova, fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të institucionit përgjegjës që të jenë motivuar nga shkaqet e pretenduara, pasi fillimisht ajo duhet të plotësonte kërkesën minimale lidhur me provueshmërinë e paraqitjes së kërkesës, ankesës apo dokumentit mjekësor të saj pranë punëdhënësit, lidhur me veprimet që ai duhet të ndërmerre.

Pra, në analizë të sa më lart, Komisioneri vëren se ka mungesë të theksuar të elementëve të provueshmërisë së deklarimeve verbale të ankueses (nuk ka depozituar asnjë shkresë, dokument apo provë tjetër). Vetëm pasi ankuesja të provonte para KMD-së se ka paraqitur apo njohur punëdhënësin me dokumentet sipërcituar, atëherë Komisioneri mund të vihej në lëvizje për të kërkuar informacion lidhur me veprimet apo mosveprimet e strukturave të IEVP Berat.

Për rrjedhojë, për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja “ç” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrotjtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ...ç) ... nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim⁵”, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka informacion të

⁵ Për analogji citojmë: Vendimin nr. 163, datë 14.08.2023, të KMD-së, Vendimin nr. 205, datë 19.10.2023, të KMD-së, Vendimin nr. 226, datë 06.11.2023, të KMD-së, etj.

mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, e për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit nr.10 221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues E. S, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA